

VENDIM
Nr. 53, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ATEANI ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19 pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 22/4 prot., datë 15.2.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Ateani Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 334, datë 19.12.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Ateani Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim, ERE me shkresën nr. 22 prot., datë 6.1.2023, ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim dhe i ka bërë me dije se në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nëse shoqëria, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

- Shoqëria “Ateani Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 22/1 prot., datë 7.2.2023, brenda afatit të sipërcituar ka përcjellë dokumentacion plotësues për aplikimin e saj për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Ateani Energy” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b”, “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “b” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “b” dhe “c” dhe pikën 2.5.

- Nga ky aplikim rezulton, gjithashtu, se mungon dokumentacioni si vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim:

- Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”

- Germa “c”: Shoqëria ka depozituar të njëjtën strukturë organizative për veprimtarinë e prodhimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike, për këtë arsye shoqëria duhet të përcjellë në ERE strukturën e dedikuar për veprimtarinë e tregtimit për të cilën kërkon të licencohet.

- Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”

- Germa “a”: Shoqëria ka përcjellë vetëm vërtetimin e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, i cili nuk është i integruar me vërtetimin e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, për këtë arsye shoqëria duhet të përcjellë në ERE dhe këtë vërtetim.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor, sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Ateani Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti